



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 18.03.2022,
e cila filloi në orën 10:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zariqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Amir Simnica (LDK), Fadil Aliu (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Liridon Selmani, (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Munguan: Berat Lahu (LVV) dhe Kushtrim Mushica (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, Bersant Beka, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Donat Lushaku, drejtor i Drejtorisë së Kadastrit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit, Krenar Xhaferi, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Adelina Sahiti, drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Granit Rugova, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Besianë Musmurati, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gërdovci, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it, Liridon Restelica, përfaqësuesi i NPL "Prishtina Parking", qytetarë dhe përfaqësues të medieeve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina**, kryesues, i cili para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, i njoftoi të pranishmit lidhur me një ndryshim që ka ndodhur në ndërkohë në përbërjen e grupeve parlamentare, respektivisht për

Faqe 1 nga 19

atë se znj. Arbnore Ajeti është larguar nga GP i subjektit politik AAK dhe ka kaluar në GP të subjektit politik PDK.

Pasi që u konstatua kuorumi për këtë mbledhje, u hap diskutimi për rendin e ditës.

Gëzim Sveçla, në emër të GP të LVV-së, kërkoi që pikat tre dhe katërt të hiqen nga rendi i ditës, për shkak që vlerësojmë se arsyetimi që është sjellë këtu për t'u trajtuar këto pika nuk qëndron, sepse kemi të bëjnë me disa opinione ligjore të cilat kanë ardhur nga MAPL-ja, që janë të pasafatshme, të paskohshme, andaj mendojmë se janë të pavlefshme.

Po ashtu, kërkojmë që të shtohet një pikë e re e rendit të ditës, pasi që MAPL-ja e ka dhënë një opinion ligjor për çështjen e formimit të Komitetit për komunitete dhe ka vlerësuar se ai vendim është i paligjshëm. Për të qenë ky komitet funksional, kërkojmë që të bëhet ndryshimi i këtij vendimi dhe të bëhen propozimet adekuate nga grupet përkatëse.

Sami Boroci u shpreh i pajtimit me parafolësin që pika e tretë dhe e katërt e rendit të ditës nuk kanë asnjë justifikim, argumentim të plotë që duhet me u anuluar, kur e dimë se ky plan është votuar në fund të vitit 2021 dhe nuk ka asnjë logjikë me u kthyer edhe një herë mbrapa. Po ashtu, duhet pasur parasysh që Harta zonale është vonuar dhe nuk ka faj kjo qeverisje, sepse ka qenë premtimi i qeverisa së kaluar që harta zonal me ardh në vitin 2021, mirëpo në ende nuk e kemi atë hartë. Andaj, propozoj që këto dy pika të largohen, se nuk e shoh të rrugës, sepse i kemi votuar edhe plane tjera. Sipas kësaj tash a të kthehemi e ti anulojmë të gjitha planet tjetra, kur tash ka kaluar një periudhë që banorët e kësaj lagjeje kanë mundur me krijuar marrëdhënie kontraktuale, qoftë me ndërtuar, dhe se shohë të rrugës të kthehet mbrapa. Nëse ekzekutivi ka ndonjë arsyetim më të mirë, atëherë po e dëgjojmë edhe po e diskutojmë, mirëpo për mua nuk ka logjikë me u kthye mbrapa, plus ky vendim ka ardhur prej Ministrisë mbrapa afatit ligjor, pas 42 ditësh dhe nuk ka asnjë logjikë.

Po ashtu, propozoj që në rend të ditës të futet për diskutim vendimi i kryetarit për rritjen e çmimit të taksive, te pjesa e startit. Kisha dashur me pas diskutim në Kuvend. E di që si Kuvend ligjërish nuk mundemi me e anuluar një vendim të tillë, se është vendim i kryetarit, por si Kuvend mundemi t'i japim një rekomandim kryetarit që ta shqyrtojë edhe një herë këtë vendim, ose të paktën ta kemi ndonjë interpretim nga Zyra ligjore.

Bahri Gashi tha se propozimvendimet për anulimin e vendimeve të lartcekura, për mua janë absurde, dhe mendoj se ky anulim nuk duhet të hyjë sot. Kryetari me ekzekutivin këtë çështje duhet me e trajtuar pak më shumë. Si pasojë e anulimit të këtyre vendimeve, shohim se këtu afër sallës së Kuvendit janë qytetarët e atyre lagjeve që kanë ardhur me i kundërshtuar këto anulime, pra dhe duke pasur parasysh rrethanat edhe diskutimet e parafolësve, ju kisha lut që këto dy pika të mos futen në rend të ditës, por me shikuar mundësinë se çka mundemi me ndihmuar e jo me i anuluar.

Kryesuesi i hodhi në votim propozimet e të tri grupeve parlamentare, LVV-së, AAK-së dhe AKR-së.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për (që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës) dhe më 22 vota kundër (që kjo pikë të mos shtyhet), Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", nr. 01-350/05-245432/21, i dt. 12.11.2021, mbetet në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 5 vota për (që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës) dhe më 40 vota kundër (që kjo pikë të mos hiqet nga rendi i ditës), Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D 2" në kuadër të Plani rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr.35-94056, të dt. 04.05.2015, mbetet në rend të ditës për diskutim.

Lidhur me propozimin për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për komunitete diskutuan: Jeta Rafuna - Hasani, Fatos Dibra dhe Leutrim Retkoceri. **Jeta Rafuna - Hasani** tha se para se ta procedojmë për votim këtë propozim që të futet në rend të ditës, kërkoi nga kryesuesi që të jepet ndonjë sqarim se çfarë dokumenti ka kthyer Ministria dhe pse e ka konsideruar të paligjshëm. **Fatos Dibra**, përfaqësues nga Zyre ligjore, tha se përbërja e atij komitet duhet të jetë në përputhje me përfaqësimin e etniteteve politike në Kuvendin komunal. **Leutrim Retkoceri** theksoi se në mungesë të materialit për këtë pikë, propozoj që kjo pikë të sillet në mbledhje e radhës në KPF, të sqarohet arsyeshmëria me shkrim, pastaj të procedohet. Si GP jemi kundër që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e z. Sveçla.

Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 24 kundër, Propozimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komitetit për komunitete, nuk futet në rend të ditës për diskutim.

Lidhur me propozimin për anulimin e Vendimit të kryetarit për rritjen e çmimit të auto-taksive, Fatos Dibra, tha se diskutim mundet me u bë në Kuvend, e që kompetencat e kryetarit e të Kuvendit janë kompetenca të ndara, Kuvendi nuk anulon vendime të kryetarit.

Fadil Aliu theksoi se këtu kemi të bëjmë me një çështje që është kompetencë e kryetarit, prandaj kjo mundet me qenë si pjesë e debatit në pikën "Te ndryshme". **Gëzim Sveçla** tha se vendimi i kryetarit për rritjen e çmimit të taksive, mendojmë se nuk ka mbështetje ligjore, se caktimi i tarifave është kompetencë e padeleguar e Kuvendit. D.m.th. vetëm Kuvendi mund ta marrë atë vendim, kështu e thotë edhe ligji.

Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, 18 kundër dhe 1 abstenim, hyn në rend dite propozimi: Diskutim lidhur me vendimin e kryetarit për ngritjen e tarifës së auto-taksive.

Kryesuesi konstatoi se, me ndryshime dhe plotësime, më 44 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës;
2. Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2022;
3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", nr. 01-350/05-245432/21, i dt. 12.11.2021;
4. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056, dt. 04.05.2015;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve;
6. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
8. Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit;
9. Informatë për gjendjen me pandeminë COVID-19 në komunën e Prishtinës;
10. Informatë mbi gjendjen në NPL "Prishtina Parking";
11. Diskutim lidhur me vendimin e kryetarit për ngritjen e tarifës së auto-taksive;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës.

Sami Boroci bëri vërejtje në transkript, duke thënë se në disa raste gjatë diskutimit fjalia nuk është e përfunduar, pasi që janë vënë pika pika, pra nuk është dëgjuar diskutimi apo çka ka qenë.

Kryesuesi tha se aty ku nuk është dëgjuar diskutimi, është dhënë pika-pika (.....).

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 39 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Doruntinë Maloku, drejtoreshë.

Nora Kelmendi, në emër të GP të LVV-së, tha se ky vendim është mjaft i mangët dhe është në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloren që u potencua nga drejtoresha, pasi që kjo listë fillimisht nuk e përmban miratimin e interesit publik, qëllimin dhe dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave që duhet të përmbajnë. Kjo listë nuk e përmban datën e publikimit të njoftimit, periudhën kohore, po ashtu në këtë listë nuk janë të përfshira certifikatat e pronës dhe kopjet e planit. Kërkojmë që mundësisht, në ndërkohë të na sillen këto dokumente dhe të vërtetohet se këto prona janë komunale.

Jeta Rafuna, në emër të GP të LDK-së, tha se ne sot kemi një listë me 51 parcela të cilat e dimë që gjatë vitit 2022, do të jenë në dispozicion për dhënie në shfrytëzim, në pajtim me Ligjin, nr. 06L 092, dhe si GP e përkrahim këtë pikë.

Leutrim Retkoceri, në emër të GP të PDK-së, tha se publikimi i kësaj liste të pronave publike është një shenjë e mirë për transparencën, është një shenjë e mire për llogaridhënien, dhe besoj për këtë do të jepen edhe vlerësime të organeve të larta.

Muhamet Selmani tha se qytetarët e Prishtinës presin në listë me vitet të tëra për shpronësimin e pronave të tyre, që për arsye të caktuara janë bllokuar dhe nuk mundën t'i shfrytëzojnë.

Në qoftë se ne e bëjmë një listë të tillë sikurse kjo, ku çdo qytetar e sheh pronën e vetë e cila do t'i shpronësohet për arsye të caktuara të Planit rregullues apo një çështje të caktuar. Lidhur me listën që e kemi përpara jam i gatshëm me e dhëne kontributin dhe njohurinë që e kamë për këtë fushë.

Kërkoj të dijë se kjo listë a është përfundimtare apo mund të plotësohet. Gjithashtu kërkoj të dijë se çka nënkuptohet me atë grososje, edhe në qoftë se janë grososje për ndonjë materie, a ka studime për këto që të bëhet apo gjera të tjera.

Gëzim Sveçla tha se këtë vendim të cilin ne duhet ta votojmë, ku pjesë përbërëse janë edhe materialet të cilat po i kërkojmë, e në fakte nuk i kemi parë hiq, d.m.th. kemi me votuar diçka që nuk e kemi, por nuk kam dyshime se janë prona të tjetërkujt ato, por veç pse s'është zbatuar në përpikëri ky vendim.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për, 1 kundër dhe 14 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2022.

Pika e tretë

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kalabria", të dt. 12.11.2021.

Lidhur me Propozimvendimin për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kalabria", të dt. 12.11.2021, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, kryetar i Komunës.

Gëzim Sveçla tha se ky Kuvend në mandatin e kaluar, më 10.11.2021, ka votuar për Planin e hollësishëm zhvillimor të lagjes "Kalabria" dhe ka nxjerrë një akt ligjor. Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, vendimet e nxjerra nga Kuvendi kalojnë përmes filtrave ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke shqyrtuar ligjshmërinë e akteve, prandaj dhe ne konsiderojmë se ky plan ende është në fuqi.

Lidhur me këtë ceku se, duke pasur parasysh që sot është propozuar që të bëhet anulimi i këtij plani, ne si GP i LVV-së, në shenjë pakënaqësie e lëshojmë sallën.

Valbona Ajeti, në emër të GP të AAK-së tha se edhe ne do ta lëshojmë sallën dhe do të qëndrojmë mbroptë asaj vote që ne e kemi dhënë në mandatin e kaluar.

Jeta Rafuna - Hasani, në emër të GP të LDK-së theksoi se ne jemi për shfuqizimin e këtij plani, pra ta bëjmë një ridizajnim më të mirë të tij, e që do të jetë edhe më i mirë për banorët e lagjes "Kalabria" dhe miratimin e tij në afatin sa më të shpejtë.

Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, tha se këtë Plan rregullues që e kemi votuar vjet pa asnjë arsytim shtesë, e në ndërkohë ministri i Planifikimit Hapësinor e kthen si të kundërligjshëm dhe ua pamundëson qytetarëve ndërtimet në pronat e tyre. Edhe pse afatet kohore të ligjshmërisë edhe shqyrtimeve janë të tilla që nuk lejojnë më shpejt se gjashtë muaj, ne po mundohemi ta bëjmë maksimumin që ju me i shfrytëzuar ato të drejta. **Sami Boroci** u shpreh se kur e kemi votuar këtë plan, ideja e krejt Kuvendit ka qenë me i barazuar koeficientet, për shkak se te parcelat e ngjitura ka pasur dallime shumë të mëdha të koeficienteve, prandaj nuk ka logjikë për mua me e anuluar një vendim të tillë. Po ashtu, duhet pasur parasysh se lagja "Kalabria" është njëra prej lagjeve më të anashkaluara edhe në aspektin infrastrukturor, është lagje e ngulfatur. Mendoj se se është gabim me e anuluar sot një plan të tillë.

Gëzim Mehmeti theksoi se mungesa e transparencës në këtë çështje ka ardhur deri tek komplikimet, prandaj mendoj se ne kemi përgjegjësi mos me i shti qytetarët në lajthitje, dhe kemi përgjegjësi institucionale e juridike në këtë rast. Marrja e një vendimi të tillë sot paraqet shkelje dhe jam kundër veprimeve kur jam në dijeni për shkelje të tilla, për atë arsye i bashkëngjitem opozitës.

Fadil Aliu u shpreh se unë jam për rishikim të planit dhe me një shpejtësi maksimale me ardhur prapë dhe me u bërë zgjidhja lagjes "Kalabria" dhe shumë lagjeve të tjera që janë duke pritur.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Para se të hedhet në votim kjo pikë, Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 26 anëtarë të Kuvendit.

U konstatua se më 25 vota për, u miratua Vendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kalabria", të dt. 12.11.2021.

Pika e katërt

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.

Lidhur me këtë propozimvendim Përparim Rama, kryetar, tha se ky vendim në aspektin procedural është i jashtëligjshëm dhe është kërkuar nga MAPL shfuqizimi i tij.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për, u miratua Vendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01. nr. 35-94056, të dt. 04.05.2015.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e lokacion të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve.

Lidhur me caktimin e lokacion të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Përparim Rama, krytar.

Jeta Rafuna-Hasani tha se ne si GP e përkrahim dhënien në shfrytëzim të lokacionit për strehimin e kafshëve.

Leutrim Retkoceri theksoi se edhe ne si GP deklarohe mi për votimin e këtij propozimvendimi.

Agim Kuleta tha se ky përcaktimi i lokacionit për strehimin e kafshëve, është një prej kauzave të mia edhe personale, kështu që e konsideroj tepër të rëndësishme. Lidhur me këtë çështje kërkoj të dijë se a ka ndonjë afat kur pritet me filluar procesi i ndërtimit të kësaj strehimoreje, edhe e dyta, a planifikohet që aty të qëndrojnë përgjithmonë qentë endacakë apo vetëm të trajtohen dhe të lirohen.

Gëzim Sveçla pyeti se kur mendohet që të finalizohet kjo hapësirë, dhe a është shqyrtuar opsioni se ekziston rreziku për kontaminim e ujit të Badocit, pasi që aty afër është një përroskë.

Bahri Gashi tha se në media kam rastisur një strategji që është duke u punuar rreth kësaj problematike, po ashtu aty janë disa kontrata që janë realizuar dhe brenda një viti, deri sa të finalizohet ky projekt, kërkoj të dijë se edhe ne anëtarët e Kuvendit a mundemi të jemi pjesë e asaj strategjie, me e dhënë edhe ne një kontribut për këtë çështje.

Gëzim Mehmeti tha se problemi i qenve endacakë është një problem që pengon qytetarin e Prishtinës dhe zgjidhja e këtij problem është tejet pozitive. Ne pa dallim partiak, e shohim si veprim të mirë dhe vetëm kisha kërkuar nga Kryetar që me qenë pak më i rezervuar në afate kohore.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Përparim Rama, kryetar.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 13 abstenime, u miratua Vendimi për caktimin e lokacion të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.

Jeta Rafuna - Hasani, për anëtarë të ndërmarrjeve publike lokale propozoi:

Në ngrohtoren e qytetit "Termokos", Jeta Rafuna - Hasani dhe Milazim Vitija;

Në Ndërmarrjen Publike Banesore, Leutrim Retkoceri dhe Granit Geci;

Në kompaninë rajonale të mbeturinave "Pastrimi", Muhamet Selmani dhe Shegë Beqiri-Badivuku;

Në ndërmarrjen publike lokale "Hortikultura", Kumrije Shabani - Ramadani dhe Arbnora Ajeti;

Në ndërmarrjen publike lokale "Trafiku Urban", Agron Canolli dhe Fatmir Dervishi;

Në ndërmarrjen publike lokale "Sport Marketing", Pëllumb Bajqinovci dhe Elmire Nikçi - Rexha;

Në ndërmarrjen publike lokale "Stacioni i Autobusëve", Donjeta Dragusha dhe Amir Simnica;

Në ndërmarrjen publike lokale "Prishtina Parking", Lindita Rexhepi dhe Sami Salihu;

Në ndërmarrjen publike lokale "Kuzhina Qendrore", Dasmor Durmishi dhe Agim Kuleta;

Në ndërmarrjen publike lokale " Pallati i Rinisë", Dhurata Retkoceri dhe Fiknete Bejta.

Sami Boroci tha se formimi i këtyre komisioneve është tepër i rëndësishëm, andaj lus kryetarin e Komunës që këto komisione të aksionarëve të jenë funksionale dhe aty të dërgohen njerëz profesionistë, sepse gjendja në ndërmarrjet publike, sidomos e disave prej tyre, është jashtëzakonisht e keqe, si në aspektin e likuiditetit, në aspektin financiar dhe në aspektin e performancës.

Endrit Zabërgja tha se çdo punë e mirë për Prishtinën duhet me gjetur mbështetjen e të gjithëve, prandaj edhe ne do të jemi për çdo punë të mirë me e mbështetur.

Gëzim Sveçla ngriti shqetësim rreth formimit të këtyre komisioneve, i cili tha se me këtë ndarje me të vërtetë këtu po shihet se nuk ka të bëjë fare me plane, me strategji, por tipike ndarje e interesave mes partive, secila parti ndërmarrjet e veta.

Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Vendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Feim Osmani kërkoi që të sqarohet në detale se si do të formohet ky këshill, rolin dhe detyrat përafërsisht, sepse sipas analizave që u kemi bërë materialeve, kemi ardhur në përfundim se ka gabime logjike, gabime procedurale, por edhe gabime në përmbajtje. Lidhur me shqetësimin e z. Osmani, sqarime të nevojshme dha Osman Billaca, ish- anëtar i këtij këshilli. Po ashtu sqarim shtesë dha edhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore.

Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Pika e tetë

Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit.

Lidhur me punën e Drejtorisë së Inspeksionit, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë.

Ermal Osmani kërkoi të dijë se sa inspektorë ka Komuna dhe a ka mjaftueshëm për t'i mbuluar zonat që janë të përcaktuara për mbikëqyrje.

Sa i përket sektorit të rendit publik, lirimi i trotuareve dhe hapësirave publike është obligim dhe prioritet, sepse rrezikohet direkt jeta e qytetarëve nga veturat, por një pjesë e trotuareve janë të uzurpuara e jo të liruara, e të tilla trotuare ka në të gjithë Prishtinën. Po ashtu, kërkoi të dijë se çfarë roli ka inspektori në lidhje me ndërmarrjen publike "Prishtina Parking".

Fadil Aliu tha se kam pasur fatin ta vëzhgoj drejtorin e Inspeksionit nga afër edhe mënyrën dhe qasja e adresimit të kërkesave të qytetarëve dhe bashkëpunimi me qytetarë për të mirën e Prishtinës, që ka qenë impulsive edhe ju inkurajoj me vazhduar atë qasje, sepse veç i ka dhënë frytet e saj.

Bahri Gashi kërkoi nga drejtori i kësaj drejtorie që në aktivitetin e tij me punën e inspeksionit, nëse kishte pasur mundësi, policia me qenë pak më e fshehtë, që mos me dalë shumë e vrazhdë, se atëherë po del që Komuna po e përdor policinë kundër qytetarit të vet.

Feim Osmani tha se sektorit të pyjeve duhet t'i kushtohet kujdes më i veçantë, pasi që shkatërrimi i tyre po bëhet në masë të madhe. Njëherësh kërkoi nga kjo drejtori që mbrojtjes së pyjeve t'i kushtohet shumë rëndësi dhe të shtohet numri i inspektorëve.

Sami Boroci tha se në rrugët: "Rexhep Luci", "Fehmi Agani" dhe rruga "B", sidomos ditëve të fundjavës, të premtëve dhe të shtunave aty organizohen ndejat prej nga ana e gastronomeve, e në fakt krijohet shumë zhurmë nga zëri i muzikës, kështu që kjo është një çështje mjaft e rëndësishme dhe kërkoj që në këtë drejtim të merren hapa konkret.

Gëzim Sveçla kërkoi të dijë se a është kompetencë e Inspeksionit me u marrë me çështjen e lypsarëve në shesh.

Njëherësh kërkoi të dijë procedurën rreth shpenzimeve për heqjen e lodrave nga parku i Taukbaçës, gjegjësisht për pastrimin e asaj hapësire shpenzimet a janë bërë nga pala që kishte kontratën apo nga Komuna.

Arianit Beqiri tha se për intervenimin që është bërë tek zyrat e partisë së LDK-së, te Qafa, a kanë pasur leje për ndërhyrje edhe në rast se nuk kanë pasur, kur do të ndërhyjni aty?

Rashit Gashi ngriti shqetësim rreth bllokimit të trotuareve nga disa autobusë të linjave ndërrbane, kryesisht në rrugën "Tirana" dhe në një pjesë të rrugës "Dritan Hoxha" afër pallatit të medieeve. Ai kërkoi nga drejtori që të merren masa për lirim të trotuareve, si dhe hapësirave gjelbëruese përreth atyre rrugëve.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Florian Dushi, drejtor.

U konstatua se u përkrah Informata për punën e Drejtorisë së Inspeksionit

Pika e nëntë

Informatë mbi gjendjen me pandeminë COVID-19 në komunën e Prishtinës.

Për Informatën mbi gjendjen me pandeminë COVID-19 në komunën e Prishtinës të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku.

Violeta Salihu kërkoi të dijë se a është ende aktiv shtabi emergjent dhe nëse po, a po bëhet mbikëqyrja e rasteve të infektuara përmes komunikimit me profesionistë apo me anëtarë të shtabit, a po bëhet gjurmimi i kontakteve dhe a po raportohen këto në institut.

Bahri Gashi e falënderoi drejtorin për informatën e dhënë dhe për aktivitetin e tij e të stafit punues, të cilët gjatë kohës së pandemisë kanë dhënë një kontribut për shërimin e të infektuarve nga virusi.

U konstatua se u përkrah Informata mbi gjendjen me pandeminë COVID-19 në komunën e Prishtinës.

Pika e dhjetë

Informatë mbi gjendjen në NPL "Prishtina Parking".

Lidhur me Informatën për gjendjen në NPL "Prishtina Parking", në pika të shkurtra të pranishmit i njoftoi Alban Zogaj, nënkryetar, i cili tha se në seancën e kaluar u pajtuan të gjithë që situatat dhe ankesat lidhur me ndërmarrjen "Prishtina Parking" duhet të konsultohen dhe duhet të analizohen me seriozitet të lartë, kështu që kryetari ka marrë një vendim për të caktuar një komision, i cili do të bëjë ndryshim - plotësimin e Rregullores së për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës. Ky komision përbëhet nga këta anëtarë:

Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit;

Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës;

Florian Dushi, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit;

Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe

Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për gjendjen e kësaj ndërmarrje, përkritazi me sfidat dhe vështirësitë që ka, në pika të shkurtër të pranishmit i informoi Liridon Restelica, drejtor ekzekutiv.

Fadil Aliu dha një sugjerim për grupin punues lidhur me projektregulloren, që kur të zgjerohet aktiviteti i "Prishtina Parking" për ndonjë rrugë të re, të ketë një fushatë vetëdijesuese, për shkak të ankesave që kanë ardhur nga qytetarët.

Leutrim Retkoceri falënderoi kryeshefin e kësaj ndërmarrje për fazat e fillimit të inicimit të plotësim-ndryshimit të Rregullores për shfrytëzimin e parkingjeve, që është jashtëzakonisht e rëndësishme, ndërsa sugjeroi që për të formuar këtë komision, do të ishte e rrugës që anëtarët e Kuvendit, grupet politike t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre. Do të ishte mirë që paraprakisht qytetarët të takohen, të diskutohet, t'u sqarohen dispozitat si ato në rregullore dhe qëllimet që i ka ndërmarrja në dobinë e interesit publik, gjë që është qëllimi kryesor i funksionimit, si për sinjalizimin e vend-parkingjeve etj. Një problem që vlen të diskutohet, është edhe bllokimi dhe konfiskimi i automjeteve të qytetarëve. Pavarësisht dispozicionit, sanksioni është shumë i shpejt dhe baza ligjore mbetet me një pikëpyetje.

Po ashtu, një e metë e madhe është që në të gjitha lagjet ka vërejtje për një sjellje jashtëzakonisht të vrazhdë të punëtorëve me qytetarët, prandaj kisha kërkuar që edhe në të ardhmen të japim kontributin e mjaftueshëm që të rregullohet shërbimi dhe të bëhet shërbim edhe më i mirë.

Bahri Gashi tha se shërbimi në parkingje duhet të jetë i mirë, por megjithatë ka shumë parregullsi, sidomos ato skena me banorë po janë pak të vrazhda, jo të mira, mungon hapësirë për parking të personave me nevoja të veçanta. Sa i përket komisionit për plotësim-ndryshimin e rregullores, tha se do të ishte mirë që ai komision të përfaqësohet edhe me një përfaqësues të qytetarëve.

Po ashtu, kisha kërkuar që hapësirat e parkingjeve para objekteve të banorëve rezidentë të ju lihen banorëve, sepse njëfarë të drejte ata e kanë pak më shumë sesa ne që shkojmë aty.

Sami Borovci tha se kur e kemi formuar këtë ndërmarrje publike për shërbim të qytetarëve, ideja ka qenë që atyre banorëve rezidentë t'u krijohet fillimisht hapësirë për parkimin e automjeteve të tyre. Po ashtu, do të ishte mirë që paraprakisht me e pasur një komunikim me qytetarët, sidomos të pjesëve të caktuara që janë pjesë më të ngarkuara. Jemi që ta ndihmojmë konsolidimin e mëtejshëm të ndërmarrjes, por normalisht edhe me e monitoruar funksionimin e saj.

Muhamet Selmani sugjeroi që të gjitha ato vërejte dhe propozime që u dhanë nga parafolësit për ndërmarrjen "Prishtina Parking", të shkruhen në letër, t'i drejtoni në komision, ose së paku secili grup ta delegojë nga një anëtar nga grupi i tyre, i cili do t'i përfaqësojë dhe t'i propozojë këto ndryshime apo plotësimi të rregullores, të statusit dhe çmimoreve. Tani në çdo vend kemi parkingje, por pak është problemi tek banesat kolektive, që besojë se duhet të rregullohet me një rregullore të veçantë, por ajo nuk mund të dal ad-hoc, duhet të testohet, ta shohim cila është më e mira.

Triera Kasumi-Berisha u shpreh e pajtimit me parafolësit mbi faktin që ndërmarrja "Prishtina Parking" është relativisht e re, por kjo nuk e lejon ndërmarrjen të bëjë shkelje të rregullores dhe shkelje të tjera procedurale dhe ligjore. Një prej vërejtjeve rreth funksionimit të kësaj ndërmarrje është edhe mungesa e transparencës, e që në fakt për

derisa nuk kemi pasur transparencë, duhemi ta kemi një llogaridhënie, kjo për arsye se ne kemi marrë fakte nga qytetarët që kemi pas standarde të dyfishta sa u përket subjekteve juridike për rezervimin e parkingjeve dhe kostove të saj.

Ajo kërkoi nga kryeshefi i kësaj ndërmarrje, që për hir të transparencës rregulloret e brendshme të bëhen publike, kështu që mosrespektimi i rregullores ka quar në probleme edhe më të thelluara, për shkak se në rregullore specifikohet që është e drejtë dhe obligim të bëhet shenjëzimi, e ky shenjëzim nuk ka ndodhur. Po ashtu, ajo kërkoi nga kryeshefi i ndërmarrjes të informojë se si menaxhohet transparenca në sistemin e digjitalizuar, meqë kemi pasur raste ku janë dhënë shumë gjopa të cilat janë kërkuar të paguhen brenda 1 ore, shumica e pagesave janë realizuar kesh dhe qytetarët nuk kanë marr një kupon fiskal.

Gëzim Sveçla, fillimisht kërkoi nga kryesuesi që të dëgjohet edhe zëri i qytetarëve, përderisa ata janë prezent këtu në sallë. Ai më pas shtoi se sipas Ligjit të Policisë, mbikëqyrjen dhe zhvendosjen e mjeteve të cilat janë parkuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji për parking e kryen policia, po ashtu mbikëqyrjen dhe zhvendosjen e mjeteve mund ta kryejnë edhe persona e autorizuar të Komunës, me kërkesë dhe me pëlqim të policisë", prandaj kërkoi të dijë nga menaxhmenti i kësaj ndërmarrje se a e posedojnë pëlqimin e policisë për këto veprime.

Mungon transparenca, biletat tek "Prishtina Parking" shiten në rrugë, në kafiteri, dhe shumë çështje të tjera të cilat u përmenden nga parafolësit e të cilat po shkaktojnë tensione. Se nuk është gjendja mirë me "Prishtina Parking" e dëshmojnë protestat e përditshme të qytetarëve në çdo lagje. Ai i propozoi kryetarit që në këtë fazë në të cilën jemi, deri në miratimin e rregullores së re, të bëhet një pezullim i zgjerimit të aktiviteteve, jo me e ndalur punën, por me i zgjeruar aktivitetet deri sa qartë të bëhet rregullorja e re dhe të vazhdohet me punë.

Arbër Vokri tha pyeti se a ka ndonjë parashikim se kur mund të bëhet një studim ose një analizë prej kësaj ndërmarrje për kapacitetet e saja në menaxhim të parkingjeve, se sa ka në dispozicion parkingje, sa ka vetura në qarkullim që duhet të akomodohen në ato parkingje, sepse një informatë e tillë ndoshta edhe i zbut pak tensionet në raport me qytetarët.

Fadil Aliu sa i përket transparencës në këtë ndërmarrje, tha se mbetet të shihet në raportin e auditimit, dhe besoj se do t'i vë të gjitha këto parregullsi në pah, dhe pastaj do të adresohen në grupin punues të gjitha parregullsitë që mund të dalin nëse ekzistojnë si të tilla. "Prishtina Parking" është kompani e sapokrijuar dhe veç sa ka filluar të ecën, t'i ndihmojmë le të drejtohet me gjithë kapacitetin tonë që kemi.

Rashit Gashi ngriti një shqetësim të banorëve lidhur me aplikacionin, e që sipas deklaratimit të banorëve, thuhet se ai aplikacion që nuk është aktiv prej vitit të kaluar, diku prej 15 tetorit, dhe përkundër pagesave që po i bëjnë, ato nuk kanë shkuar në adresë të caktuar dhe ka pasur gjopa. Nuk e dijë se a qëndron ky konstatim i tyre dhe nëse nuk është aktiv me e deaktivizur atë aplikacion që mos të pësojnë qytetarët.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Berna Saraçi tha se në lagjen "Bregu i Diellit", rruga "Vëllezërit Gërvalla", aty është vendosur një laurë (rampë), e cila është përkrahur, por të njëjtën kohë është kundërshtuar prej disa banorëve, andaj kërkoj të dijë se si qëndron gjendja me atë laurë, pasi që tash e ka bllokuar më shumë rrugën sesa që e ka lehtësuar komunikacionin aty. **Ermal Osmani** kërkoj të dijë nga menaxhmenti i ndërmarrjes "Prishtina Parking", se çfarë roli ka Drejtoria e Inspektionit në lidhje me "Prishtina Parking".

U konstatua se u përkrah Informata mbi gjendjen në NPL "Prishtina Parking".

Pika e njëmbëdhjetë

Diskutim lidhur me vendimin e kryetarit për ngritjen e tarifës së auto-taksive.

Lidhur me diskutimin rreth vendimit të kryetarit për ngritjen e tarifës së auto-taksive, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Alban Zogaj, nënkryetar.

Gëzim Sveçla shprehu mendimin, duke thënë se Kuvendi është organi që i ndryshon tarifat dhe jo kryetari dhe lidhur me kë çështje kërkoj një interpretim ligjor nga Zyra ligjore.

Lidhur me vërejtjen e ngritura nga z. Sveçla, sqarime shtesë dhanë Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, dhe Alban Zogaj, nënkryetar.

Jeta Rafuna-Hasani tha se ky vendim i kryetarit do të stimulojë trafikun urban dhe besoj se kjo nëse ndikon në të mirën e përbashkët, natyrisht që ne do ta përkrahim.

Leutrim Retkoceri tha se është brengosëse dhe shqetësues ngritja e çmimeve pothuajse në të gjitha produktet, sidomos ato ushqimore, më pas ato të luksit, mirëpo duhet pasur parasysh që kur e trajtojmë një çështje si të tillë, duhet për të gjitha çështjet me pasur parime të njëjta. Pikën të cilën tani po e diskutojmë, nuk mendoj që prodhon ndonjë vendim sa i përket kompetencës së Kuvendit komunal.

Bahri Gashi shprehu mendimin se do të ishte më mirë që të merremi me taksitë ilegale sesa me çmimin e taksive, se me të vëretetë janë bër të tepërt në komunikacion. Fatkeqësisht, ata janë të papunë, ndoshta duhet me menduar edhe për punësim, por mendoj se ajo është bërë një far industrie goxha e madhe e biznesit, që po punojnë edhe po bëjnë një far konkurrence jo të drejtë.

Sami Boroci tha se ideja është që në Prishtinë me përdorur taksitë nuk është lluks, shumë njerëz e përdorin për me mbërriri në punë me kohë ose me dalë gjatë orarit të punës dhe për shumë nevoja të tjera. Në disa lagje të qytetit mungojnë linja të autobusëve, dhe është më se e nevojshme përdorimi i auto-taksive. Konsideroj se marrja e një vendimi të tillë nga ana e kryetarit është i ngutshëm dhe i gabuar, andaj kërkoj që nëse ka vullnet një dakordim ose rekomandim për ekzekutivin prej të gjithave grupeve, që me e rishikuar edhe një herë këtë vendim. Sa i përket lirimit të nxënësve nga pagesa, konsideroj se në këtë fazë ka diskriminim të pjesëve ku nuk ka trafik urban, kështu që ideja është që sa ma shpejt me gjetur një formulë që transporti për nxënësit të rregullohet ose subvencionohet edhe përmes kompanive private.

Mirsad Vitia tha se sa i përket vendimit për lirimin e disa kategorive nga pagesa për trafikun urban, e kuptoj edhe e vlerësoj qëllimin e mirë që e ka Komuna, mirëpo si të

veprohet për ata banorë të atyre lagjeve të cilat nuk kanë qasje në trafikun urban, e që rast konkret do të ishte Hajvalia, e cila operon me kompani private, e çfarë faji kanë nxënësit e shkollave fillore ose policia, ose zjarrfikësit të cilët udhëtojnë nga ajo lagje në Prishtinë që nuk kanë mundësi lirimi nga pagesa.

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Boroci dhe z. Vitia, sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Arianit Beqiri shprehu mendimin se qarkullimi me taksi në qytetin e Prishtinës nuk është një luks, për shkak se mungesa e madhe e trafikut urban të obligon që shpesh herë të përdorësh taksi, sidomos në ato lagje që nuk kanë fare trafik urban.

Sa i përket vendimit që është marrë për lirimin nga pagesa për disa kategori në trafikun urban, mendoj se kjo nuk është një zgjidhje e përgjithshme, pasi që kemi nxënës që udhëtojnë nga disa lagje ku operojnë vetëm kompanitë private. Do të ishte mirë që të mendohet në shtimin e më shumë linjave të trafikut urban edhe nëpër lagjet e tjera të qytetit.

Gëzim Mehmeti tha se për shkak të rrethanave të krijuara, na janë shkaktuar edhe krizat, si ajo ekonomike dhe të tjera, prandaj dhe ne duhet të kemi përgjegjësi ta mbrojmë në këtë rast qytetarin e Prishtinës. E them me plot përgjegjësi, se përdorimi i taksive shpesh bëhet për shkak se shumë lagje nuk e kanë të rregulluar çështjen e trafikut urban dhe duke pasur parasysh këto, kisha pyetur kryetarin se a është në gjendje ta shfuqizojë vendimin bazuar në rrethanat e krizës ekonomike, në interes të qytetarëve të Prishtinës. Po ashtu, kërkoj të dijë nga nënkryetari, se në programin e koalicionit a do të jetë pa pagesë transporti për qytetarët e Prishtinës, premtim i cili është dhënë.

Fadil Aliu tha se vendimi i kryetarit është i arsyeshëm, andaj mendoj që duhet të bëhet edhe një praktikë që periudhat e gjata kohore të një çmimoreje duhet rishikuar, andaj ne jemi të vetëdijshëm tash e sa herë janë rritur çmimet e të gjitha produkteve. Konsideroi se kjo rritje është e arsyeshme, plus asaj që është një komoditet me udhëtuar me taksi.

Triera Kasumi - Berisha shprehu mendimin se më mirë kishte me qenë që çmimi për auto-taksi me u rritur për kilometër, e jo në start, pikërisht për disa kategori të njerëzve që e përdorin taksin si mjet alternativ për udhëtim.

Lidhur me vërejtje e ngritura nga parafolësit sqarime shtesë dha Alban Zogaj, nënkryetar.

Milazim Vitija tha se ka qytetarë të cilët pothuajse tërë ditën rrinë në autobus, kështu që është mirë që kjo praktikë të reduktohet, të jetë një biletë mujore, që të evitohet kjo në një vajtje dhe një ardhje.

Ajet Brajshori theksoi se sa i përket linjave të trafikut urban që operojnë në fshatrat e komunës së Prishtinës, që nga viti 2013 janë pa licencë të punës, pra ky është një problem në vete që duhet shqyrtuar. Në këto linja disa operatorë bëjnë bartjen e mësimdhënësve dhe nxënësve pa pagesë e disa të tjerë me pagesë, andaj duhet studiuar këtë çështje, ta diskutojmë dhe të shohim se si të veprojmë në të ardhmen.

Pika e dymbëdhjetë Pyetje dhe përgjigje

Arbnora Berisha për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- Është kërkesë e banorëve të fshatrave Barilevë, Vranidoll, Besi. A kanë ndonjë plan për përfshirjen e linjës urbane nëpër këto fshatra, pasi që ata që një kohë të gjatë kanë probleme me orar të rregullt të transportit publik edhe kanë kërkesë urgjente për përfshirjen e tyre në trafikun urban derisa të vijë autobusët?

Bahri Gashi, për nënkryetarin dhe kryetarin e Komunës.

- Kërkoj nga nënkryetari i Komunës që të shihet mundësia e përfshirjes së përfaqësuesve të subjekteve politike të GP në hartimin e rregullores të NPL "Prishtina Parking";
- Z. kryetar, po më intereson se a është duke u punuar rreth implementimit të Ligjit të Prishtinës, apo të ndryshimit të tij, ose ku jemi ne si kryeqytet me këtë ligj, sepse është pak e pakuptimtë me u krahasuar ne me të gjitha komunat, duke e pasur parasysh barrën që e kanë, çoftë drejtorët, çoftë kryetari, çoftë ne si asamble.

Mirsad Vitia, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe për drejtorin e Drejtorisë së Urbanizmit.

- A parashihet që të ndërtohet kanalizimi dhe kur, në rrugën "Shkëndija" në Hajvali, pasi që aty vazhdimisht kemi rrjedhje të ujërave të zeza?
- Kur do të fillojë ndërtimi i rrugës në lagjen "Qëndresa" në Matičan, tek Xhamia e re, dhe ndërtimi i rrugës "Abdullah Bojku" në lagjen "Arbëria"?
- Çka do të ndodhë me pronat e pronarëve, të cilat sipas Planit rregullues për lagjen "Sofalia" janë në zonë të gjelbër dhe pronarët nuk po mundën t'i shfrytëzojnë pronat e tyre, ku sipas Planit rregullues "Sofalia 2016-2024", në zonat e parapara për gjelbërim janë të ndërtuara dhjetëra shtëpi banimi, madje janë të pajisura edhe me leje ndërtimi, kurse disa pronarëve po u mohohet e drejta e shfrytëzimit të pronës së tyre? Një mohim i tillë i është bërë edhe qytetarit Lulzim Hajrizi, ku në parcelën e tij, e cila ndodhet në "Bllokun F 05", ku parashihet gjelbërim, në këtë bllok tashmë ka të ndërtuara shtëpi të shumta dhe prej vitit 2016 ka mbetur i bllokuar, as nuk mundë ta shes e as të ndërtojë! Në këtë pronë nuk është lejuar ndërtimi as i objekteve me karakter të përkohshëm, dhe për ndërtimin e tyre është refuzuar edhe leja e ndërtimit.
- Po ashtu, rruga "Avdullah Bojku" në lagjen "Arbërie", e paraparë për ndërtim në pronë publike, a do të lejohet ndërtimi dhe kur?

Petrit Reçica, për kryetarin e Komunës.

- Në takimet që i ke mbajtur, me gastronomet, ke premtuar që edhe sivjet kemi me u liruar prej taksës së tarracave, ashtu si ka ndodhur në vitin 2021 dhe 2020, dhe pyes se a ka me ndodhur sivjet ashtu qysh keni premtuar në fushatë?
- Duke e kërkuar programin e juaj që e ke bërë gjatë fushatës, nuk mund ta gjeja askund online asnjë premtim që e ke pasur në program.

Faqe 15 nga 19

Arbër Vokri, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe për kryetarin e Komunës.

- Kur do të bëhet riparimi i rrugës në fshatin Koliq, gjegjësisht rruga te lagja "Qoku", ku ajo pjesë e rrugës shërben për ta lidhur me kryeqytetin një pjesë të Gollakut?
- Banorët e fshatit Bardhosh kanë një shqetësim që nuk është përfshirë në buxhetin e ri ndërtimi i shkollës, ashtu si ka qenë e paraparë me buxhetin e mëhershëm, dhe shkolla që është prezent, tash parashihet me u rrënuar, ata po mendojnë se është ide më e mirë me ndërtuar për çerdhe.
- Në lagjen "Dardania", në rrugën "Ilaz Kodra", saktësisht blloku 9, emërtimi i saktë LB1 d.m.th. është një pjesë e një ndërtese të ashtuquajturë "Novi Domi", që janë duke u përmblytur bodrumet prej rrjedhjeve të vazhdueshme të ujit aty edhe rrezikon statikën e ndërtesës dhe nga kjo dukuri banorët janë të rrezikuar. Banorët kërkojnë që kjo rrjedhje e ujit të evitohet sa më shpejt.

Arianit Beqiri, për kryetarin e Komunës.

- A jemi duke menduar të krijohen rezerva të ushqimit, që në rast hipotetik që mund të ndodhë ndonjë katastrofë më e madhe në Kosovë të jenë ato, dhe më duket se nëpërmes Kuzhinës Qendrore ato do të mund të përdoren, që në rast nevojë të krijohen rezerva shtesë?
- A do të bëhet testimi i alarmit të qytetit dhe a do të filloni ta provoni sërish në qytet se a po funksionon kjo?
- A do të merren masa rreth zyrave të LDK-së për ndërhyrjen që e kanë bërë në objektin e tyre?

Feim Osmani, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

- Për fshatrat Rimanishtë, Vranidoll dhe Tenezhdoll nuk është paraparë asnjë investim në buxhetin e miratuar të vitit 2022. Konsideroj se është bërë një padrejtësi jashtëzakonisht e madhe, sepse nuk është respektuar lista prioritare që e kanë bërë banorët e fshatit, bashkë me organet e Këshillit të Bashkësisë Lokale. Janë buxhetuar 250 mijë euro për një segment rruge Rimanishtë - Siçevë, i cili nuk ndikon, nuk ka asnjë pah të domosdoshëm shpejt e shpejt tek banorët. Janë anashkaluar kanalizimi dhe ujësjellësi, që ka qenë tentim i disa viteve më përpara për me u realizuar dhe sot Rimanishta është e privuar edhe prej ujësjellësit, edhe prej kanalizimit.

Kërkoj nga kryetari që të gjejë mundësi me alokuar buxhet shtesë, nëse nuk mundet me dedikuar për investim tjetër atë 250 mijë euro, që konsideroj që pret si investim, sepse nuk është e domosdoshme me u kryer tash në këtë fazë.

Po ashtu, kanë qenë të projektuara rrugicat për fshatin Vranidoll, që e kapin një shumë përafërsisht 120 mijë euro, nuk ka qenë investim i madh, nuk ka hyrë në buxhet, nuk e di kush ka alokuar për me u tjetërsuar buxheti diku tjetër.

A pritet që të gjinden mjete për të intervenuar në këto tri fshatra.

Gëzim Sveçla, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit.

- Po shihet se këto ditë se nëpër rrejtët sociale, nëpër mjete të informimit e gjithandej, se asnjëherë nuk ka pasur më shumë mbeturina në Prishtinë, andaj kërkoj të dijë arsyen pse po ndodh kështu.
- Në shumë lagje të qytetit ka mungesë të ndriçimit publik, nuk po punon ndriçimi publik, andaj cilat janë masat që janë duke u ndërmarrë, kur pritet me u rregulluar, çka pritet me u bërë?
- Gatë këtij muaji ka ndodhur që në disa shkolla të qytetit të ndërpritet energjia elektrike nga ana e KEDS-it, pra si pasojë e mospagesës së faturave të rrymës, konkretisht në shkollën "Ismail Qemali", dhe është humbur mësimi për shkak se Komuna nuk e ka paguar borxhin e rrymës.
Gjithashtu, edhe për shkak të mungesës së lëndës djegëse-peletit, në shkollën fillore "Anton Zako Çajupi", në fshatin Bardhosh tri ditë nuk është mbajtur mësimi, pra kjo është e pafalshme.
Çka ka ndodhur në këtë drejtim, kush ka marrë përgjegjësi, ose cilat janë procedurat të cilat janë duke u ndërmarrë për këtë çështje?

Rashit Gashi, për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave dhe për kryetarin e Komunës.

- Dy projekte të cilat janë të azhurnuara për fshatin Mramor, njëri ka të bëjë me projektin e kanalizimit, i cili ka mbetur në gjysmë tash e dy vjet, ndërsa tjetri ka të bëjë me rrjetin e ujësjellësit në fshatin Mramor dhe Busi. Kërkoj të dijë se për këto projekte a janë duke u zhvilluar procedurat, apo do të fillojnë së shpejti?

Nora Kelmendi, për kryetarin e Komunës dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Kërkoj që në rrugën "Arbnor dhe Astrit Dehari", të hiqen disa flamuj kuq e zi, pasi që kanë mbetur prej kohës kur është festuar Pavarësia.
- Është kërkesë e qytetarëve që të hiqet taksa në transaksion, pasi që ata e paguajnë këtë taksë për regjistrimin e çdo prone. Kërkoj që të bëhet ndryshimi i kësaj rregulloreje, pasi që kjo rregullore shumë po i ngarkon qytetarët në regjistrimin e pronave të tyre. Në zbatimin e kësaj takse është e vetmja Komuna e Prishtinës dhe ajo e Graçanicës.

Violeta Salihu, për drejtoren e Drejtorisë së Parqeve, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtoren e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

- Kërkoj të dijë se vendosja e përkohshme e një shtëpize prej druri në parkun e Gërmisë, a ka pasur leje, ku rreth këtij rasti ka pasur reagime edhe nga shoqëria civile, si dhe nga disa qytetarë që e frekuentojnë Parkun e Gërmisë. Lidhur me këtë ne kemi konsideruar se ka pasur shkelje në lëshimin e kësaj leje, pasi që kompania në fjalë i ka tejkalluar kompetencat e lejes, që përveç shtëpizës ka vendosur edhe shumë makineri tjera, pajisje, gjenerator, shator. Kërkojmë që ti bëhet thirrje Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, që të shoh se çfarë dëmi është bërë atje dhe të merren masa ndaj kompanisë në fjalë.

- Kur do fillojë aplikimi i një marrëveshje bashkëpunimi në mes të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale – Qendrës për Punë Sociale dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, e cila u nënshkrua, më 12 nëntor 2021, dhe ende nuk ka filluar të zbatohet? Kisha dashur me diskutuar dhe me parë kur do të merret kjo parasysh, pasi që Qendra ka nevojë emergjente për dhurimin e mjeteve të cilat janë premtuar.
- Me rastin e përfundimit të punimeve nga kompania e produksionit filmik në Parkun e Gërmisë, aty ku kanë qenë të vendosur, a do të bëhet gjelbërimi i asaj pjese? Më intereson të dijë se a e posedon lejen, a e ka pëlqimin apo rekomandimin e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, se cilat lloje të bimëve duhet të mbillen aty?

Triera Kasumi - Berisha, për kryesuesin e Kuvendit.

- Kërkoj që mbledhjet e Kuvendit të mbahen më shpesh, dhe jo siç ka ndodhur një mbledhje për tre muaj, sepse kjo i shkakton pastaj këto mbledhjet e gjata, në të cilat po humb edhe konteksti prej lodhjes.

Ermal Osmani, për kryetarin e Komunës, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

- Në seancën e kaluar kam ngritur çështjen lidhur me Xhaminë e Çarshisë, që është premtuar nga kryetari se do të interesohet për këtë çështje, andaj kërkoj të dijë se ku jemi me këtë procedurë?
- Çështja e dytë ka të bëjë me një objekt në lagjen "Ulpiana", që i është ndërruar pamja komplet objektit banesor, në rrugën "Endrit Durhan", ku është finalizuar komplet renovimi i asaj pjese të objektit. Kërkoj të dijë se a është ndërmarrë ndonjë masë nga Drejtoria e Inspeksionit.
- A jeni në dijeni se në rrugën "Mehmet Gradica", në lagjen "Bregu i Diellit" që një muaj lagjja përreth bashkë me dy platotë është në terr total, për shkak të djegies së trafos, ku po ndodhin edhe vjedhje.

Arianit Beqiri, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit

- Në fshatrat Rimanishtë, Besi, Lebanë dhe Vranidoll raportohet që janë prerë më se 1000 hektarë pyje, andaj banorët e kësaj ane kërkojnë që të merren masa në parandalimin e prerjes ilegale të pyjeve.

Milazim Vitija, për kryesuesin e Kuvendit dhe për kryetarin e Komunës.

- Kërkoj nga kryesuesi i Kuvendit që në udhëheqjen e mbledhjes të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit, me arsyetimin se për një pikë duhet të diskutohet një herë apo dy herë nga anëtarët e Kuvendit, e jo të diskutohet disa herë nga i njëjti anëtar, e dikush asnjëherë.
- Po ashtu, kërkoj nga kryetari që të hiqet taksa në transaksion, pasi që për këtë taksë kemi ankesa të shumta nga qytetarët, të cilët po dëmtohen shumë.

Lidhur me pyetjet dhe kërkesat e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit për ekzekutivin e Komunës, përgjigje dhanë: Përparim Rama, kryetar i Komunës, Alban Zogaj, nënkryetar,

Ilirik Musliu, drejtor, Florian Dushi, drejtor, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë, Donat Lushaku, drejtor dhe Valbona Makolli, drejtoreshë.

Pika e trembëdhjetë Të Ndryshme

Përparim Rama tha se sa i përket linjave të trafikut urban, do të bëjmë një rregullore të re, e cila do të merret edhe me linjat e kompanive private. Po ashtu, me këtë rregullore do të parashihet se cilat zona duhet të jenë të frekuentuara, pra aty ku në të gjitha pikat që ka banorë. Gjithashtu kontratat e linjave të sektorit privat nga 1 vit, që kanë qenë të afatshme, tani ato do të jenë prej 5 - 7 vjet, në mënyrë që ata të marrin kredi për plotësimin e nevojave të tyre.

Donat Lushaku tha se nga aspekti i propozimit përkrahet jashtëzakonisht shumë kjo taksë që është paraparë me Rregulloren për ndryshim- plotësimin e rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, dhe është për të përkrahur propozimin e znj. Kelmendi, që vetëm Prishtina dhe Graçanica e ka një transaksione të tillë. Ky plotësim dhe ndryshim i kësaj rregulloreje do të ishte një lehtësim shumë i madh për qytetarët.

Valbona Makolli, drejtoreshë, tha se sa i përket çështjeve financiare, projektet e buxhetuara për këtë vit veç janë të kryera, dhe tash mund të bisedojmë vetëm për buxhetin e radhës, të vitit 2023. Ato mangësi që i kemi pasur i kemi paraqitur, ndërsa sa i përket çështjes së transaksionit, është një rregullore që nuk mundemi aty për aty ta ndryshojmë, na duhet kohë ta analizojmë plotësim-ndryshimin e saj.

Mbledhja përfundoi në orën 19:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Kupina**



Faqe 19 nga 19